

NJË TIPOLOGJI E NDRYSHIMIT KUPTIMOR TË FJALËVE DHE LINDJA E IMPLIKATURAVE TE REJA GJUHËSORE GJATË PANDEMISË COVID-19

Arbër ÇELIKU¹, Jetmire ALIU¹

¹Gjuhë dhe letërsi gjermane– Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës

e-mail: arber.celikui@unite.edu.mk

Abstract

The pandemic, which suddenly gripped the globe in its clutches, in addition to changing our way of life, also affected our way of speaking, communicating and behaving, and affected our entire cultural segment.

The situation has accelerated research in many areas, primarily in the field of medicine, where maximum efforts are made to find an adequate cure, but there is no research left in the field of psychology and sociology, because the situation of pandemics significantly affects in human psychology and in the overall social course.

The Coronavirus lightly invaded media discourse and public discourse, giving us linguists ground for research in many areas: the meaningful change of words, the introduction of new words, the construction of specific metaphors, the widespread use of sarcasm, irony, and so on.

The aim of this paper is to address these areas of public discourse and to create the typological linguistic framework at the time of the Corona crisis.

Keywords: *Typology of semantic change, new linguistic frame, language in pandemic time, Albanian language*

1. Hyrje

Pandemia, e cila papritmas në kthetrat e veta e mbërtheu mbarë globin, përveç që e ndryshoi mënyrën tonë të jetesës, ajo ndikoi edhe në mënyrën tonë të folurit, të komunikimit dhe të sjelljes, si dhe preku mbarë segmentin tonë kulturor.

Situata e krijuar ka përshpejtuar hulumtimet në shumë sfera, në radhë të parë, në fushën e mjekësisë, ku bëhen përpjekje maksimale për gjetjen e kurës adekuate, por nuk kanë mbetur pas hulumtimet edhe në fushën e psikologjisë dhe sociologjisë, ngaqë situata e pandemisë ndikon dukshëm në psikologjinë e njeriut dhe në rrjedhën e gjithmbarshme shoqërore.

Virusi korona rrufeshëm e pushtoi diskursin mediatik dhe ligjërimin publik, duke na krijuar neve gjuhëtarëve terren për hulumtime në shumë sfera: ndryshimin kuptimor të fjalëve, prurjen e fjalëve të reja, ndërtimin e metaforave specifike, përdorimin e gjerë të sarkazmit, ironisë, etj.

Punimi në fjalë ka për synim të trajtojë këto sfera të ligjërit publik dhe të krijojë kornizën tipologjike gjuhësore në kohën e krizës së koronës.

Fenomeni i dinamizmit gjuhësor

Siç dhe thotë Humboldt-i, gjuha nuk është një ergon, por një energea”, një entitet shumë dinamik, i ndryshueshëm dhe fleksibël. Gjuhët janë në kontakt të vazhdueshëm me njëra-tjetrën, pra japin dhe marrin nga njëra-tjetra dhe, në këtë proces, ato vazhdimisht ndryshojnë, janë një ujë që rrjedh, një vullkan që nuk shuhet kurrë.

Në terminologjinë gjuhësore gjejmë edhe nocionet: ‘transformim gjuhësor’, ‘ndryshime të kuptimit gjuhësor’, ‘ekonomizim gjuhësor’ e deri të ‘cenimi i gjuhës’ apo ‘prishja e gjuhës’.

Ne do t’i përmbahemi nocionit ‘dinamizëm gjuhësor’ për arsyet e mëposhtme:

- Është proces i natyrshëm, që gjuhët të japin dhe të marrin nga njëra-tjetra
- Leksiku i një gjuhe i nënshtrohet procesit të vazhdueshëm të dinamizimit si rrjedhojë e zhvillimit teknologjik, diskursit politik dhe publik global
- Mënyra e jetesës në botën globale kushtëzon implikatura të reja gjuhësore, sidomos në fushën e leksikut dhe në ligjërimin publik

Sidomos pas kthesës pragmatike-komunikuese të viteve 70-ta, gjuhën nuk duhet ta shohim si një sistem të mbyllur në vetvete, por, mbi të gjitha, si një mjet të pastër komunikimi.

Në këtë kontekst, J. Habermas, në veprën e tij: *Midis natyralizmit dhe religjionit* (2008:28), i rendit tri premisat formale-pragmatike të veprimtarisë komunikuese: hamendja e përbashkët e një bote objektive, racionaliteti, të cilin subjektet vepruese ia atribuojnë njëri-tjetrit, dhe vlefshmëria e pakushtëzuar, të cilën ata e përdorin gjatë akteve të folurit për thëniet e tyre, i referohen njëra-tjetrës dhe krijojnë aspekte të një arsyeje të çsublimuar, të interpretuar në një praktikë të zakonshme komunikuese, duke aluduar në një interpretim gjuhësor-filozofik se tendosja midis ideale dhe reales vështirë se përcakton formën adekuate të ligjërimin publik, pra që implikaturat gjuhësore depërtojnë deri në kapilarët e diskurseve të veprimtarisë së përditshme ligjërimore.

Kështu, semantika e së vërtetës ka realizuar një raport të brendshëm mes domethënies dhe kushteve të vlefshmërisë së thënieve dhe me këtë e ka hapur edhe rrugën drejt konceptioneve të një racionaliteti gjuhësor, madje komunikues, që sipas Habermas-it (po aty, fq. 32) nënkupton, se “një gjuhë natyrore mund të zëvendësohet me një gjuhë tjetër. Mirëpo, për gjuhën e diferencuar në mënyrë proporcionale si e tillë (për “pasurinë e gjinisë letrare”) nuk ka asnjë rezervë të përfytyrueshme, e cila do të mund të plotësonte funksionin e njëjtë”.

Megjithatë, në kontekstin tonë, të ndryshimit kuptimor të leksemave të caktuara apo prurjeve të reja gjuhësore gjatë pandemisë, sidomos në diskursin mediati, politik dhe në ligjërimin publik, është e tepërt të trajtohen çështjet e një detyre sistematike të fthillimit të një nocioni a koncepti me synimin e gjykimit se a bëhet mirë a keq, por të sillen dëshmi të një përdorimi pragmatik të leksemave dhe prurjeve të reja gjuhësore, kryesisht me efekt komunikimi.

2. Metodologjia e punës

2.1. Ndërtimi i korpusit të të dhënave

Për të pasur një pasqyrë më të qartë të përdorimit gjuhësor në ligjërimin publik gjatë pandemisë COVID-19, kemi vjelë burime gazetash dhe të mediumeve online, fjalime politikanësh, debate televizive, kolumna të opinionistëve të ndryshëm nga bota shqipfolëse si dhe në konsideratë janë marrë biseda të rastit.

Një tjetër burim i të dhënave është edhe Fjalori thesar i Gjuhës Shqipe (2006) prej të cilit janë shqyrtuar në mënyrë shteruese leksemat e caktuara, që në rastin e dhënë pësojnë ndryshim kuptimor gjatë përdorimit në ligjërimin publik.

Materiali i shfrytëzuar nga burimet e sipërpërmendura na krijoi mundësinë për të ndërtuar një tipologji gjuhësore përdorimi, kuptimi dhe perceptimi.

2.2. Paraqitja e rezultateve të hulumtimit

Nga analiza e korpusit të të dhënave të mbledhura, rezulton se gjatë situatës së tanishme globale, siç është rasti me virusin korona, ndryshon dukshëm ligjërimi ynë publik, duke u sjellë gjithmonë rreth tij me krijimin e fjalëve dhe lokucioneve të reja, ndryshimin kuptimor të tyre, e deri te huazimet vend e pavend nga gjuhët e huaja, sidomos nga anglishtja në diskursin politik dhe mediatik.

Fillimisht, me këtë rast, do të trajtohen disa fjalë, të cilat kanë ekzistuar në leksikun tonë, por që me situatën e krijuar, po perceptohen më seriozisht në komunikimin publik. Kështu fjala ‘epidemi’ deri para shpërthimit të virusit korona nuk e ka pasur atë fuqi shprehëse dhe e kemi njohur më shumë nga librat e historisë, beletristikës, apo ka pasur një kuptim të zbehur në konceptimin tonë kolektiv. Tani ajo merr përmasat e seriozitetit, druajtjes, ankthit, frikës e deri te tmerrit apokaliptik. Ndryshe nga fjala ‘epidemi’, fjala ‘pandemi’ ka qenë thujse e panjohur për publikun e gjerë, përveç në rastet kur është hasur në ndonjë film holivudian. Edhe në Fjalorin thesar të shqipes (2006) ajo nuk është evidentuar si e tillë, por që me situatën e krijuar, ajo po merr përdorim të gjerë në ligjërimin publik. Gjithashtu për sa kohë që ndodhemi në krizën e virusit korona, ka filluar të gjejë një zbatim të dendur në diskursin mediatik edhe fjala ‘infodemi’, në kuptimin e dezinformatave lidhur me virusin korona. Njëjtë edhe fjala ‘karantinë’ më parë është përdorur më shumë si sinonim për mbajtjen e dietës, kurse me shpërthimin e krizës së virusit, ajo po merr implikatura të tjera kuptimore: mbyllja në strehimore apo në shtëpi për disa javë, të caktuara në përputhje me udhëzimet qeveritare.

Ndër fjalët më të përdorura në ligjërim publik është togfjalshi ‘kufizimi i lëvizjes’. Deri para shpërthimit të virusit, kufizimi është perceptuar si diçka abstrakte, kur liria e lëvizjes është e garantuar edhe me kushtetutë. Siç tha edhe një studente imja gjatë ligjëratave, “kufizimi ka pasur kufizim më të gjerë se tani”. Në këtë kontekst, pra në kuptimin e një senzibilizimi të përgjithshëm, u krijua sllogani ‘Rri në shtëpi’, i cili ritransmetohet për çdo ditë nëpër programet televizive, mediat e shkruara dhe ato online. Rri në shtëpi është një paralajmërim nga infektimi, sëmundja dhe vdekja.

Edhe fjalët ‘izolim’ dhe ‘vetizolim’ gjejnë një përdorim të dendur në ligjërimin publik dhe rimarrin një forcë të theksuar semantike. Deri para pak kohësh, në dinamikën tonë shoqërore thujse ka qenë një leksemë e desemantizuar, kurse vetizolimi inekzistent, apo i mbyllur në raste unike.

Po ashtu edhe togfjalshi ‘orë policore’, i panjohur më parë, po merr një rëndësi të veçantë në ligjërimin publik, por edhe në vetë mënyrën e jetesës së qytetarëve.

Një dukuri tjetër, që po vërehet në diskursin politik dhe mediatik, është ndikimi i gjuhëve të huaja, sidomos i anglishtes, në krijimin e fjalëve të reja. Njëra ndër leksemat më të përdorshme, të përkthyer nga anglishtja është leksema ‘piku’. Për shembull:

- 1) Shefja e Epidemiologjisë në Institutin e Shëndetit Publik, Eugena Tomini thotë se **piku** i situatës me koronavirusin në Shqipëri mund të jetë java e tretë e prillit, sipas të gjitha pritshmërive, megjithatë gjithçka mbetet për t'u parë.

(“Gazeta Express”, versioni online, 2 prill 2020)

Fillimisht, përdorimi i leksemës ‘piku’ në diskursin mediatik shkaktoi huti të madhe në ligjërimin publik, por me kohën, ajo thuajse e zëvendësoi fjalën shqipe ‘kulmi’, ‘kulminacioni’ apo ‘pika kulminante’ dhe përditë e më shumë po familjarizohet në përdorimin e përditshëm.

Edhe vetë fjala e prejardhur ‘koronavirus’ është ndikim nga gjuha angleze, ngaqë shqipja nuk njeh ndërtime të këtilla gjuhësore, në shqipe duhet të thuhet ‘virusi korona’, por kjo fjalë e prejardhur tashmë është familjarizuar në përdorimin tonë të përditshëm.

Risi në sferën e arsimit qysh me shpërthimin e virusit korona është edhe mësimi on-line, për çka disa shkolla fillore dhe të mesme në Republikën e Shqipërisë kanë organizuar trajnime me mësuesit për përvetësimin e kësaj metode të re mësimdhënieje, për çka dhe kanë lëshuar certifikata. Në njërën prej tyre, të postuar në rrjetet sociale, shkruan kështu: “Çertifikatë për mësues digjital” [sic!], ku përveç gabimeve drejtshkrimore: çertifikatë në vend të certifikatë dhe digjital në vend digjitalë, lind një togfjalësh i padëgjuar deri më tani: ‘mësues digjitalë’, që gjen përdorim edhe në një dokument zyrtar.

Nga anglishtja po ashtu është huazuar togfjalshi ‘distancë sociale’, i cili po përdoret gjithnjë e më shumë në diskursin publik gjatë krizës së virusit korona. Fjala ‘distancë’ dhe rrafshi sintagmatik që ë krijon ajo si: ‘mban distancë’, ‘qëndron në distancë’ apo ‘është i distancuar’ janë përdorur më shumë në kuptimin e tërheqjes shpirtërore a shoqërore, por tani fillon e zë vend edhe kuptimi tjetër, ai i largësisë fizike, i përcaktuar deri në 2 metra në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Megjithatë, gjithsesi se në shqipe mund të përdorej togfjalëshi: ‘të mbahet largësi fizike’ dhe jo ‘distancë sociale’, kuptohet që mos të cenohej kohorencia diskursive.

Nga anglishtja kemi edhe disa prurje të reja në diskursin mediatik si: Korona-Update, Korona-Hotspot, Korona-App, Korona-Schock, etj.

Është interesant fakti, se kryesisht në diskursin politik, por me raste edhe në komunikimin publik, virusi korona rimerret përmes leksemave ‘luftë’, ‘luftë botërore’, ‘armiku i padukshëm’ ‘bombë’, ‘u krimba’, etj., që në rrafshin konceptual krijojnë metaforizime *per se*. Shembujt e mëposhtëm do ta ilustrojnë këtë:

- 2) Manastirliu: Jemi në mes të luftës

“**Lufta** nuk ka mbaruar, jemi në mesin e saj”, kështu u shpreh këtë të hënë ministrja e shëndetësisë Orgeta Manastirliu.

(“Agjencia Ina”, versioni online, 21 prill 2020)

- 3) Bill Gates on coronavirus: “The coronavirus pandemic pits all of humanity against the virus. The damage to health, wealth, and well-being has already been onormous. This is like a **world war**, except in this case, we’re all on the same side”.

(LiveMint, versioni online, 24 prill 2020)

- 4) Koronavirusi, Rama: Jemi në luftë me **armikun e padukshëm**, godet pa pyetur!

(Ora News, versioni online, 10 mars 2020)

- 5) Një lajm i keq nga testimet e djeshme, që duhet të vlejë si mësim për të gjithë Djali me Covid 19, pa simptoma, thyen rregullin e del nga Tirana drejt një zone tjetër të vendit, ku jetojnë dy prindërit e tij të moshuar. U shkon prindërve në shtëpi dhe u transmeton **bombat** në trup! [...]

(Edi Rama në profilin e tij zyrtar në Facebook, 24 prill 2020)

- 6) **U krimba** duke ndejt mbyllur në shtëpi [...]

(Dëshmi dëgjimore)

Megjithatë, gjatë një bisede rasti, kur një zonjë ia uronte shoqes së saj ditëlindjen përmes telefonit, situatën e krijuar ajo e rimori në mënyrë implicite me leksemën ‘liri’:

- 7) Dashtë Zoti kthehemi përsëri në liri [...]

(Dëshmi dëgjimore)

Përveç metaforizimeve, në komunikimin publik, por edhe në diskursin politik, hasim edhe shprehje që në vete përmbajnë sarkazëm dhe ironi. Për shembull:

- 8) Virusi Thaçi po shkel Republikën që të vendosë kurorën e laboratorit të Serbisë

(statusi i një miku në Facebook)

- 9) Pandemi ap plan-demi?

(statusi i një miku në Facebook)

- 10) Për të gjithë ata, të cilët e kanë kaluar karantinën pa ndëshkim, fitojnë edhe një muaj falas (barsoletë që qarkullon në rrjetet sociale)

- 11) Edi Rama një komentuesi në Facebook, pasi ai i ankohet për mosmundjen e organizimit të dasmës: Martohuni on-line... rëndësi ka dashuria

Përfundime

Pandemia, e cila e mbërtheu mbarë globin, jo vetëm që e ndryshoi mënyrën tonë të jetesës, por ajo e ndryshoi edhe mënyrën tonë të folurit. Sakaq fjalë dhe sintagma të rëndomta filluan të marrin peshë në ligjërimin publik. Po ashtu, fjalori i mjekësisë u pasurua me neologjizma, sidomos nga gjuha angleze, duke pasur parasysh statusin e saj në nivel global.

Si rrjedhojë, ne u përpoqëm që të gjitha këto risi gjuhësore, t'i karakterizojmë në disa tipologji më të rëndësishme përdorimi, me qëllim të kuptimit sa më të mirë të procesit të dinamizmit gjuhësor dhe ligjëritimit publik.

Trajtesa në fjalë duhet të merret si një kontribut fillestar në fushën e dinamizmit gjuhësor, e cila do t'u shërbejë gjeneratave të reja të gjuhëtarëve dhe studiuesve të shkencave të komunikimit, me synimin e thellimit të mëtejshëm në këtë fushë.

Referencat

- [1]. Akademia e Shkencave të R. së Shqipërisë. Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë. (1984): *Fjalori i Shqipes së sotme*. Tiranë.
- [2]. Akademia e Shkencave të R. së Shqipërisë. Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë. (1995): *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë.
- [3]. Akademia e Shkencave të R. së Shqipërisë. Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë. (1997): *Gramatika e gjuhës shqipe II*. Tiranë.
- [4]. Habermas, J. (2008): *Midis natyralizmit dhe religjionit*. Asdreni Shkup 2008 (vepër e përkthyer)
- [5]. Habermas, J. (2011): *Ah, Evropë*. Asdreni Shkup 2011 (vepër e përkthyer)